



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	<b>Drejtoria e Kadastrit</b>
Periudha raportuese	<b>Shkurt 2016</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit shkurt, në 5 zyrat pritëse janë pranuar gjithsejtë **2,812** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **2,728**, janë refuzuar **14** dhe kanë mbetur në procedurë edhe **117** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.**

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njërive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

Në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, gjatë muajit janar 2016, nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme.

**Në Sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- **298** kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar **207** (20 kërkesa të ngelura në procedurë nga muajt e kaluar), kemi refuzuar **14** kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me **97** konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- **15** kërkesa për përmirësim, nga të cilat **14** janë miratuar, ndërsa ka ngelur në procedurë edhe **1** kërkesë;
- **51** kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe **30** kërkesa për çregjistrim, nga të cilat janë miratuar të gjitha;
- **5** kërkesa për barra tatimore, janë miratuar në tërësi;
- **265** shkresa / kërkesa, nga institucionet e ndryshme, prej të cilave janë realizuar të gjithat nga shërbimi i RDPP-së;
- **13** kërkesa për historikun nga persona fizikë dhe institucione, prej të cilave janë miratuar të gjitha.

➤ **Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- **1094** kërkesa për certifikata të pronësisë, ndërsa **847** kërkesa për kopje të planit, gjithsej **1941 kërkesa**;
- **5** kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë miratuar **9** (4 nga muaji i kaluar), të realizuara të gjitha;
- **8** kërkesa për bashkim të parcelave, janë miratuar gjithsej **10** kërkesa (2 nga muaji i kaluar), të gjitha të realizuara;
- **63** kërkesa për dhënien e produkteve (koordinatave), të realizuar të gjitha;
- **69** kërkesa për identifikimin e njërive banesore, nga të cilat janë miratuar **61** (3 nga muaji i kaluar), 11 kërkesa në procedurë;
- **9** kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar **15** (6 nga muaji i kaluar), të realizuara të gjitha;
- **15** kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë miratuar **15** (4 nga muaji i kaluar), 4 kërkesë në procedurë;
- **24** kërkesa zyrtare për përmirësim nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., nga të cilat janë miratuar **28** (8 nga muaji i kaluar), ndërsa 4 në procedurë.

- 1 kërkesë për ndërrim kulture, e miratuar.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka zbatuar rreth **90 %** të planit të paraparë, duke i miratuar, refuzuar ose pezulluar kërkesat e palëve në procedurë, sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa. E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të marrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palë/subjektet fizike dhe juridike.

#### **4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë punë, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal,

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njërive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. *STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.*

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, janar 2016	Numri i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara - €
Certifikata të pronësisë & Kopje të planit	1,941	1,941	0	0	9,877
Vërtetim për nevoja personale (aplikim për vizë, bursë etj.)	0	0	0	0	0
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	298	207	14	97	11,670
Kërkesa zyrtare për historik, historik për persona fizikë dhe juridikë	13	13	0	0	210
Kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	265	265	0	0	0
Përmirësime në RDPP	15	14	0	1	300
Barra tatimore	5				150
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	51	51	0	51	4,690
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	30	30	0	0	300
Ndarjet - parcelimet, copëtimet	5	9	0	0	160
Incizimi i ndërtesave, banesave					
Bashkimi i parcelave	8	10	0	0	271
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	63	63	0	0	1,098
Identifikimi i parcelave dhe njësisve banesore	69	61	0	11	1,380
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	9	15	0	0	548
Ndërrim i kulturës	1	1	0	0	0
Plotësim pagese - gjeodezi	0	0	0	0	0
Kërkesat me licencë	15	15	0	4	560
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	24	28	0	4	79
<b>Gjithsej</b>	<b>2,812</b>	<b>2728</b>	<b>14</b>	<b>117</b>	<b>31,293 euro</b>

#### **4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për periudhën raportuese.**

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

#### **4.1.3. Takimet me palë**

1. **Spektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (*e martë, e enjte*) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjor, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth **383** qytetarë.
2. **Spektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë, ku gjatë muajit janar ka pranuar **257** palë për plotësim të lëndëve, sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

#### **5. Takimet me institucione të tjera**

- **Spektori i kadastrit** ka pasur takime me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale, pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'u drejtohen institucioneve të tjera në vend.
- Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyera nga kjo agjenci.

#### **6. Diskutime publike/Takimet me qytetarë**

- Nuk kemi pasur.

##### **6.1.1. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

Në Drejtorinë e Kadastrit kemi pasur vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare nga gazeta BIRN.

##### **6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër**

- **Sektori i kadastrit:**
- 677 lëndë të pranuar,
- 585 lëndë të kryera,
- 14 lëndë të refuzuara,
- 98 lëndë në procedurë.

**Vërejtje: 20 lëndë të bartura nga muajt e kaluar.**

- **Sektori i gjeodezisë:**
- 2,135 lëndë të pranuar,
- 2,135 lëndë të kryera,
- Asnjë lëndë të refuzuar,
- 19 lëndë në procedurë.

**Vërejtje: 21 lëndë të kryera nga muajt e kaluar.**

#### 7. Takime të tjera

8. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

#### **Sektori i kadastrit:**

- Sfiduese është komunikimi me institucionet, mos përgjigjet e tyre në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.

#### **Sektori i gjeodezisë:**

- Sfiduese është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mos përgjigjet e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin CadastralMap dhe SITK , të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
  - Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastral e Kosovës.
9. *REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.*

**Sektori i kadastrit:**

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

**Sektori i gjeodezisë:**

- Trajnime për punëtorë sa i përket aplikimit të Kornizës së punës;
- Furnizim me printer me ngjyra;
- Furnizim me një skaner, i cili do të ndihmonte në mbarëvajtjen e punës.

**10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues****Sektori i kadastrit:**

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose ai Ndërkomunal.

**Sektori i gjeodezisë:**

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme**

- Kërkesa në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për dhënien e një përdoruesi (*user*) të ri, në mënyrë që të mundësohet hapja e një sporteli të ri për eliminimin e radhëve të gjata të qytetarëve para sporteleve në Drejtorinë e Kadastrit.